

Mustafa I. Hoxha

FOLE,
MOJ
QAF'E 
KOSHOVICES ..



Vargje popullore

824-1
H91.

MUSTAFA I. HOXHA

FOLË, MOJ QAF' E KOSHOVICËS...



Vargje popullore

12-664

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor: RAMAZAN VOZGA
Kopertina nga MUSA QARRI

Tirazhi 1.500 Format 60x88/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1973

PËR LIRI NA DIGJEJ XHANI

Qielli mbushur aeroplanë
nga fashistët italjanë,
topat grykat po drejtojnë,
gati trupat të zbarkojnë...

Krisi pushka, u ndez zjarri,
po ku shkove, o Zog tradhtari?
Mblodhe ç'vodhe e ike i pari,
po s'dorëzohet sot shqiptari.

Se ka bij ky Durrësi plak,
se ka Mujo Ulqinak,

s'pyet jo, për zjarr' e flakë,
tokën krejt e lan' me gjak!

Kur kushtrimin dha Partia,
n'këmbë u ngrit gjith' vegjëlia,
rroku armët Shqipëria,
qe e shtrënjt' për ne liria!

Rrokëm armët, n'këmbë u
ngritëm,
nëpër male lart u ngjitëm;
të uritur, buzëtarë,
po t'vendosur luftëtarë!

Ngritëm çeta, batalione
dhe brigada, divizone,
nisëm luftën ndër llogore,
me besimin në fitore!

Për liri na digjej xhani,
ndaj s'na mposhti dot dushmani;
në çdo shteg kemi luftuar,
gjith' armiqt kemi dërmuar!

Me dyfeqet lara-lara,
posi dhënt' i vum' përpara,
ose ikën, morën dhenë,
ose eshtrat lanë e mbënë...

Dhe në fund ndriti liria,
siç ndrin dielli në pranverë,
sepse busull qe Partia,
timonier shoku Enver!

Ndaj sot flamuri i lirisë,
lart në brigje t'Arbërisë
valëvitet kuq si zjarri,
ësht' flamuri fitimtar.

KUSHTRIM MBI VJOSË

Prej Skraparit në Përmet
çet' e vogël ngjitet shpejt,
me fashistët të luftojë,
që vatanin të çlirojë.

Nat' e zezë pa hënë e yje,
çajnë rrugën nëpër 'pyje;
gjer në dhëmb' armët mbërthyer,
kalojn' Vjosën e rrëmbyer!

— Ndale, Vjosë, rrymën tënde!
Na trego ku janë vendet,

që të dalim për matanë,
ballpërball' me italianë!

Dhe një zë si shushurima
vjen nga lumi te lugina;
është Vjosa, që po flet:

— Eni trima, për matanë,
para, shokë partizanë!
Dor' për dore zënë tok,
sepse trimat s'njohin mort!
Rrymën time dallgërrëmbyer,
për çdo herë kan' kapërcyer.
Këtu shkoi Çerçizi motit,
Riza trimi, patrioti;
breg më breg më kan' kaluar,
prej armikut s'jan' diktuar!

Ikën rrjedha në Përmet
dhe një thirrje po buçet,

e po sjell një lajm gazmor
për fshatarë e 'për punëtorë:

— Pa dëgjo, ti popull mbarë,
ju punëtorë e ju fshatarë!
Partizanët po luftojnë,
mbi armikun po marshojnë,
bashkë me popull anembanë,
nën kushtrimin e Partisë
po çlironë gjithë vatanë,
çdo pëllëmb të Shqipërisë!
Pushk' e krisma që dëgjojmë
zemrat tonë i gëzojnë.

KRISI PUSHKA NË XHADE

Korriku dyzet e tre
krisi pushka në xhade,
zien toka dhe gjëmon,
batalioni po lufton!

Lart në kodër përmbi pllajë,
trim Asimi,* shok i rrallë
po u prin shokve në ballë!
Tundet vendi bubullon.

*) Asim Zeneli = Hero i Popullit.

S'pyet Kiçoku për beteja,
sa pyet qelli ç'është rrufeja!
Mu te pllaja, përmbi bar
gjashtë trima mben' të vrarë!

O Kiçok, o tok' arbërore,
gjashtë trima na i more;
gjashtë trima partizanë,
dhanë jetën për vatanë,
bijt' e tu, Shqipëri,
të mbuluar me lavdi!..

KĒSHTU THA NĒNA BUJARE

Mu te kodrat nē Shijak,
krisi pushka partizane,
u ndez vendi zjarr e flakë,
me gjermanë e tradhëtarë,
kudo toka me gjak larë.
Djemtë tanë si petrita
nëpër shkrepa, nëpër prita
u vërsulën nga çdo anë
tmerr armikut seç i dhanë.
Në mes tyre mbet i vrarë
trim Alushi* nē gjak larë...
Djal' i vetëm, trimi djalë,

*) Alush Grepcka = dëshmor i brigadës X S.

nënës, tha, m'i çoni fjalë:
«Shokët e mi kur të vinë,
nëno, do sjellin lirinë.
Prandaj, nëno, mos mbaj zi,
se pa gjak nuk ka liri.
Na mësoi Partia ne
si të vdesim për atdhe,
për agimet, që do vinë,
që do ndrijnë Shqipërinë!..»

«O Alush, o biri im,
nëna jote s'njeh vajtim!
Ti do rrosh për jet' e mot,
sepse djem kam prapë sot,
unë kam brigad' e dhjetë,
partizanë trima me fletë,
që të gjith' shokët e tu,
janë me mua, janë këta këtu!
Ti më vdiqe për atdhe,
prap ti gjall' jeton me ne...»

TUNDET VENDI SI TËRMET

Tundet vendi si tërmet
lajm i madh, lajm i vërtetë
dërgon Enver Hoxha vetë:
të krijohet sa më shpejt
brigadë e gjashtëmbëdhjetë!
Haber sa dërgoi Enveri,
u mblodh tërë Therapeli,
gjithë Skrapari an' për anë,
djem e vajza si asllanë;
brigadën seç e krijuan
dhe në luftë e pagëzuan.
Tundet mali, çahen retë,
topi, bomba po kërcet,

shpat' i Sinjës zë gjëmon
gjerman qeni po qëllon,
Vokopolën bombardon.

— ndal gjerman po të bëj be,
se këtej i gjallë s'kalon,
në vend tim s'ke seç kërkon!
ur' e Kuçit për matanë,
stiv' gjermanët mben' të vrarë!

FOLË, MOJ QAF' E KOSHOCHESES!

Qaf' e Koshovicës folë,
dhe na thuaj çfarë pe!
Po ti s'flet, se nuk ke gojë,
ndaj do flasim me ty ne!

Përmbi Fier, në Koshovicë
krisi pushka me furi,
me ballistë dhe me fricë,
luft' e madhe për liri!

C'po luftojnë partizanët
atje poshtë në xhade,

turren, sulen si luanët,
mbi armikun si rrufe!

Ësht' brigad' e gjashtmbëdhjetë
të gjith' trima të vërtetë,
që nuk pyesin ç'ësht' stuhia,
s'tundet, s'epet Shqipëria!

Ballistët tok me gjermanë
marrin vrapiç nga çdo anë,
lënë rrugëve ç'gjë kanë...
— Bini, trima partizanë!

C'i mbulon maginat zjarri,
tym' e flakë del kudo...
Abedini,* pik' e djalit,
bje në luftë si hero!

*) Abedin Spathara = dëshmor i brigadës
XVI S.

KËNGA E SADUSH VËRZHEZHËS*

Dyzet e katër, tector,
ç'po lufton me një taborr,
Sadushi na ra dëshmor!

Zjarr nga toka, zjarr nga retë,
lufton trimi si di vetë,
Sadush Vërzhezha me fletë!

Vrau ballistë e gjermanë,
porsi trimat ra në ballë,
hakun s'ia lam' pa marrë.

*) Sadush Vërzhezha = dëshmor i brigadës
XVI S.



Partizanët të thërresin,
ngreu, Sado, ty të presin,
me batare t'përshëndesin.

Pa kur i than' nënës plakë,
zemr' e saj seç u ndez flakë,
por veç lot s'derdhi aspak.

U tha shokëve të tij:
«Plakë jam, ndaj s'mund të vij,
armiq të korr e të grij.

Po ju, shokë, të vazhdoni,
si Sadushi të luftoni,
gjersa vendin ta çlironi.»

Shokët e shoqet luftuan,
hakën Sadushit ia muarr,
Shqipërinë e çliruan.

Sadush s'vdiqe, je i gjallë,
partizan me yll në ballë,
po shkëlqen si yll i rrallë.

Si që s'mundet që u fë
njeri t'i llogiq kët qëndra që
nuk mundet t'i llogiq kët
qëndra që s'ndryshet. Në
një vjet këp qëndri është
nëdhej që përfundon që
në një vjet këp qëndri
nëdhej që përfundon që

LIRIA RRËNJËT I KA NË GJAK!

Mu te shkëmbi, në të dalë
një plumb më mori në ballë.

Nënë, ti mos qaj për ne,
se ne ramë për atdhe,
qem' ushtarë të lirisë,
patëm zjarrin e Partisë
edhe gjakn' e Shqipërisë.

Qe e shtrenjtë, nënë, liria
ndaj u ngrit gjith' vegjelia,

kur kushtrimin dha Partia
mbi armiq e tradhëtarë.

Nëpër malet sì kurorë,
ecëm zbatohur nëpër borë,
s'u aorzuam, nuk u dhamë,
thirrëm: «Para, partizanë!»

U ndez flaka u ndez zjarri
në betej' isha i pari,
në beteja, në fitore,
nga llogorja në llogore.

ZIEN KIÇOKU NGA BETEJA*

Zien Kiçoku nga beteja,
partizanët tek xhadeja
po luftojnë me italjanë;
po ushtojnë e tundet dheu,
mos u ngjall prap Skënderbeu?!

Rendin tankset me zinxhirë,
aeroplanash qielli nxirë,
topa, tanke dhe murtaja,

*) Beteja është zhvilluar më 2 korrik 1943
nga partizanët e batalionit të Skraparit.

digjen shkurret nëpër pllaja.
Zjarri i egër, tym e flakë,
ç'do pëllëmb' njomet me gjak,
maj' xhadesë, mbi greminë,
partizanët s'duan t'ia dinë!

Qesh fashizmi dhe gëzon:
— Partizan, a po dëgjon,
pse Kiçokun s'e dorzon?!
S'mbahet vendi, mor i mjerë,
me dhjet' pushk' e tre mauzerë,
ç'të ka marrë koka erë!
Forcat tonë mizëri
tokën do ta bëjnë hi!

— Ndal, bre fashist' i zi!
Varu posht' në ta mban guna
të shikosh se ç'ësht' furtuna,
se si mbrohet këtu liria, —
zemër, zjarr na jep Partia

Prandaj ne s'duam t'ia dimë
për rrebesch e suferinë!

Tundet kodra dhe ushton,
mitralozi po gjëmon
mbi fashistat grin e korr,
o Skrapar, a e dëgjon?

RAMIZ* TRIMI, KOMISARI!

Mitralozi grin e korr...
ndal fashist, o shpirt mizor,
mal' i Leshnjës nuk kalohet
shqiptari kurrë s'dorëzohet!

Më mirë vdekur se sa gjallë,
me barut qëndron në ballë
edhe armën s'e lëshon,
krism' e saj prapë gjëmor!

*) Ramiz Aranitasi = Hero i Popullit.

Ramiz trimi, komisari
në betejë sulet i pari,
ju flet shokëve me piskamë:
«Para, shokë partizanë!»

Zjen beteja, shtohet zjarri,
del në krye komisari,
ball' për ball' qëndron ai
si anija në stuhi!

Po Aliu, këlysh tradhëtari,
ç'po mendon rreth atij zjarri? —
shiturë ndër italianë,
për ca pare që i dhanë,

komisarin e qëllon
përmbas shpine, e rrëzon.
O moj pushkë e tradhëtisë,
vrade birin e lirisë!

Ç'PO SULMON BRIGAD' E TETË

Vishegradi tym e flakë
bor' e bardhë skuq në gjak;
skuq në gjak, nxin tym' i zi
bini burra për liri!

Ndal gjerman se kësaj ane
i thonë luftë partizane.
Hapen qiejt, çahen retë
ç'po sulmon brigad' e tetë.

DËSHMORIT SHABAN RADËSHI*

Ashpër seç u ndez beteja,
buçet mali si rrufeja,
po buçet e po gjëmon,
Shaban trimi po sulmon!

— Para, shokë partizanë!
Sulm' o burra mbi gjermanë,
mbi gjerman' e mbi tradhtarë,
hovin ton' askush s'e ndal!

*) Shaban Radëshi = dëshmor i Grupit të Skraparit.

Kështu the, o trimi ynë,
lart u ngjite gjer në brinjë,
me gjoks zjarrin e mbulove,
edhe shokët krejt shpëtove.

Por pa pritur, pa kujtar
një plumb trupin ta ka shpuar,
ngrite shtatin si shqiponjë,
kushtrimi të mbet në gojë;

i tërë vendi mori flakë
trupi yt u la me gjak...
Edhe sot përmbi vatan
skuq si ylli partizan!

RRON AI NË ZEMRAT TONA

Në Vithkuq, atje matanë,
luftove me italjanë
bashkë me shokët partizanë,
trim, Gani,* o lule djalë!
Në këmb' plumbat seç të ranë,
shpejt të çuan në spitalë,
doktor Petrua t'u gjend pranë.
Trim Gani, o lule djalë!
brenga jote pat një mall,
se nga shokët jeshe ndarë.

*) Gani Radëshi = dëshmor i batalionit «Tomorri».

«Në betejë shokët janë,
ballë për ballë me gjermanë
dhe unë të mbetem mënjanë!»
Trim Gani, o lule djalë,
plaga këmbën lart ka marrë;
dy herë këmbënë ta prenë
po mendimet larg të venë:
«Si do bëj, the, un pa ardhë»,
trim Gani, o lule djalë.

Edhe hipur majë kalit,
siç po dilje prej spitalit,
në përpjekje prap re ti.
Krisi pushka, u ndez zjarri,
ti luftoje që nga kali,
dhe pa këmbë i bëre ballë,
o Gani, o trim i rrallë.
Dhjetra plagë të kanë marrë,
trupi yt në gjak i larë,
gjer në fund gjallë nuk u dhe
për liri e për atdhe.

KUR DOLËM PARTIZANË . . .

Do të marr dyfekun,
do të ngjesh gjerdanë,
do luftoj dhe unë,
tok me partizanë!

Frym veriu lehtë,
hëna lart ndriçon...
rrrokni armët, djema,
Partia na fton!

Çohuni se malet
po na presin ne,

mbi qiellin shqiptar
të mos ketë re...

Topat po gjëmojnë,
pushkët po kërcasin,
këngët nëpër pyje,
maleve buçasin.

S'pyesim për tufane,
s'pyesim për stuhi,
dashuri e vendit
na mban ngroht' në gji.

Si fanar Partia
shtigjeve na ndrin...
bini, more djema,
bini pa pushim!

Pushka jon' me gjalmë,
ca fishek' në brez...

dhjetë fronte çamë,
zjarrit mespërmes.

Sa na binte njëri,
vinin dhjetë të tjerë;
vuuu shiu na qullte,
bora bashk' me erë!

Jastëk vinim gurët,
kapotën jorgan,
po s'e ndalëm kurrë
marshin partizan!

Dhe këngën s'e ndalëm
malit për liri,
— ndal! — i tham' armikut,
i thon' Shqipëri!...

Dhe një dit' nëntori
kthyem prapë ne,
pa sollëm lirinë,
kaltërsin' pa re...

Në qytet ne hymë
gjith' duke kënduar,
populli na priti
me lule në duar!

Thirrëm: «Rroft' Enveri!
Të na rroj' Partia!»;
prap kënga buçiti,
qeshi Shqipëria!..

BOZHIGRAD, TREGO Ç'KE PARË

Bozhigrad, trego ç'ke parë,
fol' për trimin q'është vrarë,
që armiku t'mos kalonte.

Kur monarkot filluan zjarrin
Shyqyriun* qëlluan të parin.
Këmbët plumbi ia shporoi,
por ai luftën s'e pushoi.

«Para shok', të marrim hak,
monarkot t'i lajm' në gjak!»

Tokën tonë mos shkel' me këmbë,
është e shtrenjtë çdo 'pëllëmbë!

*) Shyqyri Hoxha, vrarë në provokacionet e gushtit 1949.

Ta marr' vesh gjith' njerzia,
se ka zot sot Shqipëria!
Kemi ne në ball' Partinë
dhe mburojë kemi ushtrinë,
kush na shkel në kufi,
e bëjm' pluhur, shkrumb e hi!
Kështu tha gjersa mbaroi,
këmb' armiku nuk kaloi.
Shyqyri, o djalë i ri!
s't'u dhimbjet a në rini.
Lum Partia që të rriti,
në beteja të kaliti.
në beteja, në luftime,
Shyqyri, o zemra ime!

S K R A P A R I T

Vendi im, tok' e zhuritur,
që të brodha an' e mbanë,
biri yt i kacafitur
me ballistë dhe gjermanë!

Bredh sërishmi tok me shokë,
poshtë kodrës, gjer në lumë...
sa kujtime ndjell kjo tokë,
eh, sa krisma, net' pa gjumë!

Eh, kjo tokë, tok' e bleruar
me gjak trimash është larë,

ndaj buron sot i kulluar,
vrulli i punës proletare.

Ne punojm' e lodhje s'ndjejmë,
~~se~~ e dim' përse punojmë,
për Partin' e pér atdhenë,
djersën tonë të kullojmë!

...Vendi im, tok' e zhuritur,
o Skrapar, o vendi im,
biri yt një këng' ka ngritur,
këng' të jetës gjith' gëzim!

TE LAPIDARI

Fryn veriu në vendin tim,
malet mbushur me blerim,
tufa, tufa grigjat lart
ngjiten, zbardhin përmbi shpat...

Dhe bariu aty pranë,
hedh vështrimin për matanë,
dhe natyrën zë këndon,
fyelli i tij diçka tregon.

Flet për luftën partizane
që buçiti kësaj ane,

për një trim, një djalë të ri,
që dha jetën për liri.

Bie fyelli me ngadalë,
një fëmij' dëgjon e ndal,
atje posht' te lapidari,
ku dha jetën kufitari.

Lapidarëve në kufi,
një buqetë vendos ai...
Malet mbushur me blerim
sa i bukur vendi im!

LAVDI REPUBLIKËS

I kaltër qelli ësht' tani,
e dielli ndrit për bukuri,
zogjtë cijasin me hare...
Republikë, e bukur je!
Ngrihesh lart plot madhështi,
nëpër shekuj paç lavdi!

Mbi gërmadha gjak vaditur,
jetën e re ne kemi ngritur:
kopshte, pallate, fabrika
bukur ndriçon Republika,
nuse veshur me stoli,
lavdi, shok, asaj lavdi!

Buçet Fierza an' e mbanë,
Laçit tej, gjer n'Elbasan,
ngado zjen e oshëtin
veprat tona në marshim.
Pesëvjeçarët tok me to
po ngrihen posı kala
shtat lëshojnë ata 'përditë...
Lavdi në shekuj Republikë!

ERDHI VETË LUMTURIA

Ndihet beli që me natë,
kush me kazm' e me lopatë,
minat krisin lart në shpat...
Kjo na erdhi nga Partia,
erdhi vetë lumturia!

Plisa, plisa tok' e re,
dhe kanali si trase,
zbret traktori në xhade...
kjo na erdhi nga Partia
erdhi vetë begatia.

Shih traktori, çan ugarë,
kodrat i përfshiu mbarë,
djem e vajza djegin *gardhë*...
kjo na erdhi nga Partia
kështu thot' fshatarësia!

KËNGË PËR RININË

Me të bërë thirrje partia,
nëpër majë u qep rinia.
U ngjit lart nga Lapardhaja,
sheshon brigje, kodra, majë,
po i kthen në toka t'reja,
mbi të vjetrën lind e reja!
Shih lart malit mbi bregore,
plot tarraca pranverore,
mbushur t'gjitha me blerim,
sa i pasur vendi im!
Ësht' e art' rinia jonë,
që punon, mëson, këndon!
Hej, parti të qofsha falë

ç'po ndriçon si diell' mbi mal!
Po ndriçon e jep shkëlqim
në çdo skaj të vendit tim!
Ti rininë ma kalite
sa dhe pleqt' i përtërите!
Mbi të vjetrën ndrin e reja,
shih, armik, se ç'ësht' ideja!

GRA E BURRA QË ME NATË

Gra e burra që me natë,
po i qepen bregut lart,
punojn,' dit' e punojn' natë,
Shqipëria yll në hartë!

Hidhi sytë kodrës lartë,
matan' lumit, më të djathtë,
atje ku qe shkëmbi i thatë,
sot po ndritka gruri i artë.

Çepan, Prishtë dhe me radhë
shiko bloqet radhë-radhë

mbjellë rrush, e moll' e dardhë...
lulëzo, o vend i rrallë!

Bukën vetë po e prodhojmë,
gjith' hambarët i zgjerojmë,
drith nga jasht' mos importojmë,
çdo blokad' të shkatërrojmë!

H E K U R U D H A . . .

Në aksione, në beteja,
po na pret rishtas e reja,
hekurudha, prap traseja,
mespërmes nga Myzeqeja!

Rishtas shina do të shtrijmë,
gjithandej do të arrijmë
kështu është porosia
nga Enveri dhe Partia!

Ziejnë kazma dhe lopata,
'prap' në sulm hidhet brigada,

gjëmojn' minat aty pranë,
shkëmbi hidhet përmatanë!

Hidhet shkëmbi, hapet udha,
zgjatet, zgjatet hekurudha...
shpo tunele dhe ngrë ura,
lavd e nder ësht' sot puna!

Ditët ikin një nga një,
koha shkon e s'kthehet më
hekurudha u mbarua,
tërë atdheu u gëzua.

PËR ADEM REKËN

Drita pa zbardhur mirë,
tej në det nisi stuhi,
bregut t'Durrësit atë ditë
valët vinin me furi.

Gjëmon' deti, dridhej toka,
dallgët vinin gjer te kodra,
vinin dallgët e gjëmonin
edhe bigën kërcënonin.

Sirena alarm njofton,
Ademi shokët po zgjon!

Thrret: «O burra të shpejtojmë,
bigën duhet ta shpëtojmë!

Drejt në breg sulet ai...
trimi njihet në stuhi.
Shpejt e shpejt ngjitet në bigë!
Kavon zë dhe e shtrëngon,
e nga dora s'e lëshon,
buçet deti me poterë
s'e lë bigën që të bjerë.

Komunisti, lule djalë,
s'pyet tallaz, s'pyet për valë!
ndaj dhe kavon s'e lëshon,
egër deti shkumëzon.

Ja, pas pak pushoi stuhia,
dhe në det ra qetësia,
por, ç'e do, një copë hekur
trimin kishte lënë të vdekur!

Erdhën shokët aty pranë,
u habitën kur e panë.
Than': «Megjithse nuk jeton,
prapë kavon s'e lëshon!»

Komunistët kështu janë,
se Partin' në zemër kanë,
kanë zjarr' e dashurisë
të punës, të Shqipërisë!

PO NDRIN DIELLI LART TE SHPATI

Janari gjashtëdhjet e shtatë,
nga puna sa filluan
pensionistë e pionierë,
shokun Enver e njoftuan.

Gurëgħħendës, muratorë,
ca teknik' e ca puntorë,
të gjith' me çekan në dorë.
vrull' e punës s'e ndalojme,
qytetin tē zbukurojmë;

Nisi puna me rrëmbim,

zgjatet rruga pa mbarim,
ziejnë kazma dhe lopata,
tang e tung kërcet çekani.
Gur' e gdhëndur, i skalitur,
si në diell guri ndritur,
ca të kuq e ca të bardhë
shtruar bukur radhë-radhë...
sepse dje vëllezrit tanë,
kur luftonin me gjermanë,
me gjerman' e tradhëtarë,
rrugët që ne po ndërtojmë
me gjak' trimash i kan' larë.

Bleroi kumblla, bleroi mani,
tang e tung kërcet çekani,
gur' i bardh' e i skalitur,
si në diell guri ndritur,
shtrohet rrugës radhë-radhë,
ca i kuq e ca i bardhë...

Po ndrin dielli lart te shpati,
kopsht me lule sot Berati!

U HAP LAJMI NË SKRAPAR

U hap lajmi në Skrapar,
fush' më fush', e mal më mal.
nga Tirana erdh' haberi,
se tek ne po vjen Enveri!...

Çorovod', qyteti im,
buçet kënga gjith gëzim,
buçet kënga kësaj ane,
si në luftën partizane.

Pyje, kodra kam kaluar,
tok me shokët kam luftuar,

mbi armiqt' e mbi tradhtinë,
për liri, për Shqipërinë!

S'pyetëm ne se ç'qe stuhia
se në ball' na priu Partia,
timonier Enveri ynë,
ball' për ball' çau stuhinë!

Pas ca vjetësh sa kujtime...
Ai vrap' sot vjen tek ne!
Çorovodë, o zemra ime,
thuaja këngës plot hare!

— Popull trim, 'popull bujar!
Ja ku prap ne u takuam,
për ju malli më ka marrë
si në kohën kur luftuam.

Pushk' e kazm' mos t'i lëshoni,
më shumë vendin zbuluron.

Çorovoda e shkretuar
shih sa bukur ësht' ndërtuar!

Kështu tha Enveri ynë,
që na solli lumturinë.
Porosit' që la Ai,
do t'i ruajmë përgjithnjë!

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Për liri na digjej xhani	3
Kushtrim mbi Vjosë	6
Krisi pushka në xhade	9
Kështu tha nëna bujare	11
Tundet vendi si tërmët	13
Folë, moj qaf' e Koshovicës.....	15
Kënga e Sadush Vërzhezhës	17
Liria rrënjet i ka në gjak,	20
Zien Kiçoku nga beteja	22
Ramiz trimi, komisari	25
C'po sulmon brigad' e tetë	27
Dëshmorit Shaban Radëshi	28
Rron ai në zemrat tonë	30
Kur dolëm partizanë.....	32
Bozhigrad, trego ç'ke parë	36
Skraparit	38
Te lapidari	40
Lavdi Republikës	42
Erdhi vetë lumturia	44
Këngë për rininë	46
Gra e burra që me natë	48
Hekurudha	50
Për Adem Rekën	52
Po ndrin dielli lart te shpati	55
U hap lajmi në Skrapar	57